

ARTIKULLI #8

BIZNESET BUJQËSORE NË RAJONIN E PEJËS JANË TË HAPURA PËR TË BASHKËPUNUAR ME UNIVERSITETET PUBLIKE:

Bashkëpunimi Industri – Universitet në Kosovë, Mbështetur nga Aktiviteti i Financuar nga USAID 'Partneritetet e Sektorit Privat për Forcimin e Arsimit të Lartë'

[AUGUST, 20, 2023]

Për më shumë foto mbi këtë artikull, shkoni në link:

<https://drive.google.com/drive/folders/1Yq9nQNgrVNWkaxIEiRezs4Nuu-SIsaMQ>

Dy dekadat e fundit kanë sjellë rritje të jashtëzakonshme në sektorin e Bujqësisë të Kosovës, i cili është shtyrë nga inovacioni dhe prezantimi i produkteve dhe praktikave të reja.

Për të mbajtur këtë momentum dhe për të forcuar konkurrueshmërinë e industrisë në shkallë globale, bizneset duhet të përqafojnë njohuritë dhe ekspertizën e avansuar në fusha kritike si, teknologjia e ushqimit, dhe agro-mjedisi dhe agroekologjia. Duke njohur këtë nevojë, aktiviteti i financuar nga USAID, Partneritetet e Sektorit Privat për Forcimin e Arsimit të Lartë, synon të krijoj lidhje të fuqishme mes sektorëve të bujqësisë dhe TIK dhe tri universiteteve publike në Kosovë.

Që nga lansimi i tij në Prill 2023, aktiviteti është duke u angazhuar me bizneset bujqësore, me mbështetje nga Universiteti i Iowa, Universiteti i Shtetit të Iowa, dhe Qendrës për Arsim e Kosovës (KEC). Curtis Youngs, këshilltari udhëheqës teknik i aktivitetit për bujqësi nga USI, udhëhoqi ekipin gjatë takimeve për të eksploruar partneritetet me agrobizneset ekzistuese në Kosovë.

Ajo që vlen të theksohet është që bizneset si **Vitoria Farm Boost Berries**, **Birraria Birra Peja**, **Ferma e Pulave Taka** dhe **Vita** (kompani e procesimit të produkteve të qumështit) kanë treguar interes të bashkëpunojnë me aktivitetin dhe universitetet, sepse këto partneritete do të ofrojnë përfitime reciproke për universitetet dhe bizneset në Kosovë.

Duke bashkëpunuar ngushtë me studentë të motivuar dhe hulumtues dhe profesorë të njohur nga universitetet publike, bizneset mund të fitojnë qasje në zhvillimet më të fundit në shkencën dhe teknologjinë e bujqësisë. Njëkohësisht, universitetet kanë mundësinë të mësojnë rreth trendeve të tregut biznesor dhe të ndajnë gjetjet e tyre hulumtuese, duke kontribuar kështu në përmirësim të infrastrukturës, përmirësim të tregut të punës, dhe një mjedisi lulëzues për agrobizneset.

Përfaqësues nga sektori privat nga disa biznese shprehën mirënjohjen dhe entuziazmin për perspektivën e partneritetit me aktivitetin në vitet e ardhshme.

"Në Vita, ne jemi të përkushtuar për të ofruar përsosmëri të produkteve të qumështit që plotësojnë standardet ndërkombëtare dhe tejkalojnë pritshmëritë e klientëve tanë. Fokusi ynë në teknologjinë e fundit të ushqimit na siguron që kapacitetet tona profesionale të mbeten në ballë të industrisë sonë. Duke bashkëpunuar me teknolog udhëheqës të ushqimit dhe ekspertë të laboratoreve, ne vazhdimisht synojmë të kultivojmë ekipe të afta dhe të pajisura mirë. Ne mburremi me forcimin e lidhjeve të forta me universitetet, duke ofruar praktika të vlefshme të punës për studentë të talentuar, duke nxitur kështu lidhje të qëndrueshme profesionale. Duke punuar së bashku me ekspertë të këtij aktiviteti, ne presim me padurim të përmirësojmë dhe rinovojmë bashkëpunimet tona jetike me universitetet." - **Rita Domniku Gjickolli, Menaxhere e Cilësisë në Vita**

"Unë do të përfitoja shumë nga marrja e njohurive mbi menaxhimin efikas të praktikave të shëndetit riprodhues për kopenë time. Të pasurit studentë të aftë, që janë prezentë në fermën time, do të ofronte asistencë të vlefshme në menaxhimin efektiv të prodhimit të qumështit. Për më shumë, ekspertiza e profesorëve, e ofruar përmes vizitave në terren apo hulumtimit të aplikuar, do të ishin shumë informative dhe instrumentale në udhëzimin e përpjekjeve të mia për të kultivuar lopë të shëndetshme të cilat prodhojnë qumësht cilësor." - **Tabë Krasniqi, CEO e Vitoria Farm**

Mbështetja e aktivitetit të USAID Partneritetet e Sektorit Privat për Forcimin e Arsimit të Lartë dhe bizneseve kosovare të bujqësisë përbëjnë një hap të rëndësishëm në progresin e rajonit për trajnim të agronomëve të ardhshëm në universitetet publike. Duke qenë se ky aktivitet lehtëson më shumë bashkëpunime mes akademisë dhe industrisë, kjo hap rrugë të reja për rritje, inovacion, dhe prosperitet ekonomik në një fushë gjithmonë në zhvillim të bujqësisë.